

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR
TË ENERGJISË PËR VITIN 2018

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur Entin Rregullator të Energjisë, si rregullatori i vetëm dhe i pavarur për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike e të gazit natyror, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

- Duke konstatuar faktin që viti 2018 shënon fillimin e prodhimit të energjisë nga impiantet fotovoltaike, prodhues të tillë i hapin rrugën një kategorie të re të klientëve, të cilat janë të përhapura tej mase në vendet e Evropës Perëndimore të quajtur *Prosumers*, të cilët prodhojnë energji elektrike për nevojat e veta dhe mund të shesin një sasi të energjisë elektrike në treg;

- Duke konsideruar që një liberalizim i mëtejshëm i tregut të energjisë elektrike synon një siguri më të lartë furnizimi dhe një zhvillim më të mirë, kompetitiv dhe transparent të tregut të energjisë elektrike;

Vlerëson për vitin 2018:

- Trendin pozitiv sa i takon uljes së humbjeve të përgjithshme të raportuara nga OSHEE për vitin 2018, të cilat arritën në masën 23,96 % krahasuar me shifrën prej 26,41% të një viti më parë dhe inkurajon OSHEE-në të vazhdojë në këtë drejtim, me qëllim arritjen e parametrave normalë të operimit.

- Nivelin e lartë të arkëtimeve në total, i raportuar nga OSHEE sh.a., i cili ishte 101,9% kundrejt energjisë elektrike të faturuar për vitin 2018, shifër në të cilën përfshihen edhe arkëtimet e prapambetura të periudhës 2007–2017.

- Miratimin nga ERE, në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, të “Planit të masave për OSHEE sh.a, për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike”, i cili identifikon qartë përgjegjësitë e furnizuesit në kuadër të detyrimit të shërbimit publik.

- Vendimet e përbashkëta që Enti Rregullator i Energjisë së bashku me entet rregullatore të Greqisë dhe Italisë, kanë marrë në lidhje me projektin TAP-AG, vendime të cilat janë marrë në përputhje të plotë me Direktivën përkatëse të BE-së.

- Miratimin e strukturës së re të ERE-s në prill 2019, kërkesë e vazhdueshme edhe në raportet ndërkombëtare, përfshirë edhe raportprogresin, si dhe nga Sekretariati i Energjisë, misionet e ekspertëve të BE-së, në të cilët është theksuar domosdoshmëria e pavarësisë dhe rritjes së kapaciteteve njerëzore të ERE-s.

- Bashkëpunimin e ERE-s, përmes përfaqësuesve të saj në 3 grupet e punës të ngritura me qëllim bërjen efektive të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, si dhe bashkimin e tregjeve të një dite më parë me Kosovën, gjithashtu po në këtë kuadër vlerëson miratimin dhe firmosjen e “Memorandumit të mirëkuptimit mbi bashkëpunimin e tregjeve ditore të energjisë elektrike mes palëve” ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës.

- Vlerëson punën e ERE-s për rishikimin e rregullores së licencimit në sektorin e energjisë elektrike, duke pasur në vëmendje përmbushjen e detyrimit për njohjen reciproke në vendet e rajonit, si dhe duke shtuar si kriter për pajisjen me licencë nga ERE edhe miratimin nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) të projektit të digës, si dhe leja e vënies në ngarkesë për herë të parë të digës e objekteve.

- Punën e bërë nga ERE në plotësimin e kuadrit ligjor me legjislacionin sekondar, në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshimeve që ky ligj ka pësuar me ligjin nr. 7/2018, si dhe në funksion të vendimeve të Këshillit të Ministrave.

- Punën e bërë nga ERE për plotësimin e kuadrit ligjor në legjislacionin sekondar, në zbatim të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” në përputhje me Direktivën 2009/73/EC, si dhe Rregullores EC nr. 715/2009.

- Punën e bërë nga ERE për reflektimin në legjislacionin aktual rregullator të ndryshimeve të nevojshme, në përputhje me Paketën e Tretë të BE-së në fushën e energjisë.

Rekomandon për vitin 2019:

- Të bashkëpunojë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe me Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë për marrjen e masave të nevojshme për monitorimin e ndarjes së OSHEE sh.a., sipas parashikimeve ligjore. Proces i cili shoqërohet me ndarjen ligjore, funksionale dhe organizative ndërmjet aktivitetit të shpërndarjes dhe Furnizuesit Universal. Nga ana tjetër, të vijojë ndarja e aktiviteteve, llogarive dhe kostove midis Furnizuesit të Mundësisë së Fundit dhe aktiviteteve të tjera, duke mundësuar shërbim të sigurt, kompetitiv, transparent dhe me cilësi të klientëve fundorë.
- Të luajë një rol proaktiv për rishikimin e akteve ligjore dhe nënligjore respektive, gjatë periudhës transitore, për bërjen efektive të ndarjes ligjore dhe funksionale të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
- Të vijojë bashkëpunimin me aktorët e mandatuar për operimin dhe monitorimin e Bursës së Energjisë.
- Të propozojë ndryshimet e nevojshme pranë MIE për zbatimin e kërkesave të certifikimit të operatorëve të transmetimit në përputhje me opinionin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
- T'i kushtojë një vëmendje të veçantë implementimit të planit të masave nga OSHEE sh.a. në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit, si dhe përditësimit të tij në funksion të problematikave që kanë dalë përgjatë zbatimit të tij, duke u fokusuar në zgjidhjen e ankesave të klientëve në një kohë sa më të shkurtër. Lidhur me zbatimin e tij, të monitorojë në mënyrë periodike, çdo tre muaj, OSHEE-në dhe të informojë çdo katër muaj Kuvendin e Shqipërisë.
- Të punojë, në bashkëpunim me aktorët e tjerë, nga njëra anë për nxitjen e investimeve në impiante të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, si centralet fotovoltaike, eolike, biomasë etj., investime të cilat sjellin edhe një diversifikim gradual të prodhimit të energjisë, dhe nga ana tjetër të bashkëpunojë me MIE në përgatitjen e kuadrit ligjor dhe rregullator për thithjen e tyre, si dhe uljen e kostove apo dhe shpërndarjen e drejtë të tyre tek të gjithë klientët.
- Të bashkëpunojë me MIE për kryerjen e një vlerësimi për menaxhimin e riskut hidrologjik në mënyrë që të menaxhohen risqet e rritjes së kostove të furnizimit të energjisë elektrike për klientët fundorë, për shkak të kushteve klimatike, si dhe të konsiderojë mundësinë e krijimit të një fondi garancie nga KESH me përfitimet financiare të nxjerra gjatë një viti hidrologjik të mirë, të cilat mund të kompensojnë riskun financiar të një viti hidrologjik jo të mirë.
- T'i kushtojë vëmendje të veçantë, gjatë vitit 2019, implementimit të strukturës së miratuar dhe rekrutimit të një stafi sa më të aftë profesionalisht për përballimin e sfidave të sektorit të energjisë dhe gazit natyror, profesionalizmi i stafit ka ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së punës dhe pavarësisë operacionale të ERE-s.
- Të vazhdojë punën së bashku me entet rregullatore të Italisë dhe Greqisë për marrjen e vendimeve dhe nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse për projektin TAP-AG dhe krijimin e kushteve për hapjen e tregut të gazit natyror në vendin tonë, në përputhje me direktivën 2009/73/EC dhe Rregulloren 715/2009, EC.
- Të japë opinion për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe atë të Financave dhe Ekonomisë për gjetjen e rrugëve dhe zgjidhjeve për shuarjen e detyrimeve reciproke midis operatorëve publikë të sektorit të energjisë elektrike dhe marrjen e masave për parandalimin e krijimit të tyre në të ardhmen.
- Të punojë për hartimin e një strategjie për infrastrukturën kritike në sektorin e energjisë, në përputhje me direktivën e BE-së "Mbi sigurinë e sistemit dhe sistemeve informatike", duke përfshirë në listën e këtyre infrastrukturave dhe infrastrukturat e kompanisë publike të gjenerimit apo dhe impiantet private të gjenerimit, të cilat mund të kenë impakt në sigurinë territoriale.
- Të bëjë vlerësimet e propozimeve të paraqitura nga OSHEE, pas përfundimit të "Studimit të vlerësimit të humbjeve të energjisë elektrike në traktin e lidhjes nga njësi gjeneruese deri në

pikën e lidhjes me rrjetin e OSHEE sh.a.”, lidhur me humbjet e OSHEE-së prej pikës së lidhjes së prodhuesve të energjisë.

- Të kërkojë nga OSHEE, që pas shtyrjes së afateve të përcaktuar në rregulloren “Kriteret Standarde të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes të Energjisë Elektrike”, shtyrje në të cilën OSHEE kërkojë një aplikim të përshkallëzuar për të miratuar nivelin e lejuar të kriterëve standarde të performancës në zona të ndryshme, respektimin që brenda kësaj periudhe shtyrjeje shoqëria të dorëzojë në ERE një studim të detajuar mbi përshkallëzimin e realizimit të parametrave të kërkuar sipas zonave të sipërcituara dhe vënien e treguesve për monitorimin e tyre.

- Të caktojë afate konkrete për OSHEE-në lidhur me vënien sa më shpejt në punë të sistemit të ri të faturimit, të paktën në disa projekte pilot të identifikuara nga vetë OSHEE, i cili lehtëson në mënyrë të ndjeshme leximin e matjes së energjisë dhe krijon mundësi dhe opsione të reja, duke përfshirë edhe leximin periodik disamujor, si dhe në përfundim të konsultimeve me palët e interesit, aty ku kushtet teknike të kompanisë e lejojnë, të sigurojë përfshirjen në kontratën tip për vitin 2019 të kësaj mënyre leximi të sistemit të matjes.

- Të kërkojë nga OSHEE që në periudhë afatshkurtër të mundësojë lidhjen në rrjetin e shpërndarjes të impianteve fotovoltaike në ndërtesa, nxitja e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme është një prioritet i përcaktuar edhe në ligjin përkatës.

- Të vijojë punën për mbrojtjen e konsumatorit përmes kompetencave që i jep ligji, mosrespektimi i afateve për shërbimet përkatëse, sjelljet arbitrare dhe të papërgjegjshme ndaj klientëve vijnë të mbeten problem me gjithë uljen e numrit të ankesave pranë ERE-s. OSHEE duhet të ofrojë një qasje të re për shërbimin e kujdesit ndaj klientit.

- Të kërkojë nga OSHEE anulimin e faturimeve të klientëve të energjisë elektrike, të cilët janë faturuar nën emërtimin “energji e pamatur” dhe “dëm ekonomik” në periudhën tetor 2008–prill 2011. Me gjithë vendimin e ERE-s, problemi vijon të mbetet i pazgjidhur.

- Në bashkëpunim me OSHEE-në dhe institucionet përgjegjëse, të mbështesë propozimet për dhënien e një zgjidhjeje të problemit të pronësisë së kabinave elektrike, 51,3% e të cilave nuk janë në pronësi të OSHEE-së, si dhe të disa rrjeteve shpërndarëse të energjisë në pronësi private, duke krijuar kështu pengesa për të drejtën e ndërhyrjes dhe kryerjen e shpenzimeve financiare nga ana e OSHEE-së në rastet e nevojshme, si dhe të japë opinion nëse është e nevojshme për ndryshimet në legjislacion për zgjidhjen e këtij problemi në të ardhmen.

Miratuar në datën 20.6.2019

KRYETAR
Gramoz Ruçi